

A jam i (e) detyruar të vaksinohem?

Vendimi për t'u vaksinuar është plotësisht në dorën tuaj. Ju mund të konsultoheni me mjekun familjar, farmacistin (en) tuaj ose çdo profesionist tjetër të kujdesit shëndetësor tek i cili ju keni besim. Mos hezitoni t'i drejtoheni atyre për çdo pyetje që ju duket e nevojshme në mënyrë që të merrni vendimin e duhur. Nëse vendosni të mos vaksinoheni, vendimi juaj do të respektohet patjetër. **Vaksina është falas.**

Kush do të më vaksinojë ?

Duke pasur parasysh kushtet e ruajtjes së vaksinës, vaksinimi do të bëhet në kushte të përshtatshme. Për personat që paraqesin disa rreziqe për shëndetin, vaksinimi do të organizohet në përparësi në **qendrat e vaksinimit**. Këto qendra do të jenë të disponueshme më pas për pjesën tjetër të popullsisë.

A mund të rifilloj një jetë « normale » ?

Vaksinimi nuk do t'i japë fund menjëherë pandemisë së COVID-19 por ai do t'ju mbrojtë në mënyrë pothuajse të plotë sapo të keni marrë dozën e dytë.

Si fillim, vaksinimi është **një masë shtesë li dhur me masat parandaluese të cilat duhet të vazhdojnë**. Por kjo do të lejojë gradualisht, lehtësimin e masave lidhur me distancimin social dhe gjetjen pak nga pak , të disa lirive të mëparshme siç janë : rifillimi i aktiviteteve të ndryshme të kohës së lirë , takimi me të afërmit, etj.

PËR TË DITUR MË SHUMË

Ky informacion është vënë në dispozicion për ju nga mjeku familjar, farmacisti (ja) juaj ose çdo profesionist tjetër **i kujdesit shëndetësor** në të cilin ju keni **besim**

Faqja e internetit jemevaccine.be ju orienton lidhur me informacionet përkatëse dhe ato të vlefshme nga ana shkencore.

COVID-19

A do të vaksinohem?

INFORMACIONE
për **pacientët**


je me vaccine.be
#jemevaccine


je me vaccine.be

Éditeur responsable: J. Riguelle | Rue de la Rivelaïne 21, B-6061 Charleroi | Janvier 2021
Numéro de dépôt légal D/2021/7646/1



Përse shërben VAKSINA ?

Kur jemi të sëmurë për shkak të një infeksioni, sistemi mbrojtës i trupit tonë, i quajtur « **sistemi imunitar** », lufta kundër agentit patogjen i cili është përgjegjës (për viruset, bakteret, etj.) nje substancat karakteristike të agentit patogjen (antigenet) dhe prodhon substanca që synojnë neutralizimin ose zhdukjen e tij : **antitruapat**.

Të vaksinohemi, do të thotë të fusim në organizmin tonë një agent patogjen që është i **padëmshëm** ose një copë agjenti patogjen « të zgjedhur mirë». Sistemi ynë imunitar reagon duke prodhuar të njëjtët antitruapa për t'i luftuar.

Nëse pas kësaj, ne jemi të infektuar nga agjenti i « vërtetë » patogjen, mbrojtjet tona imunitare të aktivizuara nga vakcina mund të neutralizojnë dhe të shmangin sëmundjen : atë që ne e quajmë « **kujtesa imunitare** ».

Që nga shekulli 19-të, kërkimet mjekësore kanë lejuar prodhimin e vaksinave të ndryshme që ne **të mbrohemi nga sëmundjet infektive** si për shembull : tërbimi, tetanozi, poliomeliti, ethet e verdha, fruthi, difteria, gripi ose shumë të tjera.

Vaksinat kundër COVID-19

Vaksinat e para (vakcina e firmës Pfizer dhe Moderna) të disponueshme janë të përbëra nga një molekulë që quhet ARN mesazher (mRNA) e cila përmban informacionet në mënyrë që vetë trupi ynë të prodhojë lëndë kalimtare antigjene. Antigjeni do të provokojë atëherë, një **përgjigje imune** dhe do të prodhojë antitruapa që **synojnë shkatërrimin e virusit**.

Për këto vakcina, **dy doza janë të nevojshme**. Doza e dytë duhet të bëhet tre javë (21 ditë) për vaksinën Pfizer dhe katër javë (28 ditë) për vaksinën Moderna, pas dozës së parë. Këto vakcina ju mbrojnë shumë kundër sëmundjes (afërsisht 95% e mbrojtjes totale).

PËRPARËSI PËR PERSONAT MË TË DOBËT DHE MË TË RREZIKUAR

Qëllimi është që të paktën 70% e popullsisë të vaksinohet për të siguruar imunitetin kolektiv. Por, të gjithë njerëzit nuk mund të vaksinohen në të njëjtën kohë. Duke u mbështetur në mendimin e ekspertëve, Këshilli i Lartë për Shëndetin ka përcaktuar **publikun që ka përparësi dhe fazat e njëpasnjëshme** lidhur me bërjen e vaksinës.

Faza e parë përfshin personat e moshuar që jetojnë në institucionet për të moshuarit dhe stafin e tyre. Pastaj, punonjësit më të rrezikuar të shëndetit, personelin dhe rezidentët e strukturave kolektive të kujdesit shëndetësor (lidhur me invalidët dhe ata që kanë probleme të shëndetit mendor, etj) si edhe personat me shëndet më të dobët.

Së fundi, pjesa tjetër e popullsisë.

PËRSE duhet të vaksinohem?

Arsyeja e parë është shmangia e **COVID-19**, pasojat e të cilit mund të jenë rënda. Kjo është mënyra më efikase për **t'u mbrojtur**. Vaksinimi ndihmon gjithashtu në **lehtësimin e mbingarkesës në spitale**.

Më në fund, kur një numër i madh i njërëzish do të vaksinohen, ne mund të rifillojmë **aktivitetet më normalisht, duke respektuar**, në radhë të parë , **gjestet pengesë të përhapjes së virusit**.

Cilat janë efektet e padëshirueshme lidhur me vaksinimin COVID-19?

Si me të gjitha ilaçet, vaksinat mund të provokojnë **efekte kalimtare të padëshirueshme si** : temperaturë, lodhje, dhimbje koke ose një reaktion lokal në vendin ku është bërë gjilpëra si : (dhimbje, skuqje, fryrje, etj.).

Në raste të rralla, një reaktion më i rëndë (alergji) mund të shfaqet. Asnjë efekt tjetër i padëshirueshëm serioz ose afatgjatë nuk është zbuluar deri më sot, por meqenëse vakcina është e re, ky rrezik nuk mund të përjashtohet plotësisht.